Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-72
Datë 12.02.2019

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 05.02.2019 nxjerr këtë:

VENDIM

1. Validohet dhe akreditohet LENA 5 Sh.P.K me adresë, rruga "Haradin Bajrami," p.n. objekti Budakovë, Lipjan, për periudhën një vjeçare 05. 02. 2019 deri 05.02.2020 me kualifikimet:

   1.1. Grimier/ Grimiere, Niveli III sipas KKK me 19 kredi të AAP

   1.2. Manikyrist/ Manikyriste, Niveli III sipas KKK me 6 kredi të AAP

   1.3. Parukier/ Parukiere, Niveli III sipas KKK me 78 kredi të AAP

2. Numri i kandidatëve që lejohet për grup duke u bazuar në hapësirën fizike, në pajisjet dhe mjetet e punës për ushtrimin praktik për secilin kualifikim është:

   - Grimier/Grimiere 10 kandidatë
   - Manikyrist/Manikyriste 8 kandidatë dhe
   - Parukier/Parukiere 10 kandidatë

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, raporti i vlerësimit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara, rekomandimeve që bazohen në dëshmi dhe dokumentet e ofruara: Aplikacioni për validim të kualifikimit/modulit; aplikacioni për akreditim si institucionit ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; raporti i vetë-vlerësimit; vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumentet tjera shtesë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi i dërgohet:

- LENA 5 Sh.P.K
- AKK

Kryetarja e KD së AKK-së
Violeta Dema